

VENDIM
Nr. 80/2015

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 69/2015 “PËR CAKTIMIN
E NJË ANËTARI ZËVENDËSUES NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË SISTEMIN E DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 3, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 69/2015 “Për caktimin e një anëtari zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, bëhen këto shtesa:

I. Pas pikës I shtohen pikat I/1 dhe I/2 me këtë përmbajtje:

“I/1. Të caktojë si anëtar zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë deputetin e Grupit Parlamentar të PS, Vexhi Muçmata.

I/2. Të caktojë si anëtar zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë deputeten e Grupit Parlamentar të PD, Jorida Tabaku.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 16.7.2015